



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1745/2 Prot

Rrëshen më, 23 . 06 . 2025

V E N D I M

Nr. 39 datë 19. 06. 2025

**PËR
“PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE”,
BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 24.01.2025, "Për miratimin e buxhetit 2025", VKB nr. 115, datë 27.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", relacionin nr. 1745 prot. datë 29. 04. 2025, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Z. Kastriot Gjini Përlika", nga sektori i shërbimit social të bashkisë, së bashku me projektin e Kryetarit Bashkisë, shqyrtimin e miratimit me ndryshim në mbledhjen e datës 30.05.2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, për t'a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, i propozuar 60 000 lekë, miratohet me ndryshim në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;
 - a. **Paksim:** Fondi rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;.....100 000 lekë
 - b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.....100 000 lekë
2. Pagesa të kalojë me bordero, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



KRYETAR

Aleksandër PICAKU

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË
P/V E N D I M

Nr. 1745 / Prot
12

Datë 21/05 /2025

Nr. 41 date 21 .5. .2025

“PËR PERDORIM FOND REZERVE ”

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ne ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, 115/2024, “Per buxhetin e vitit 2025” “Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, në udhëzimin nr.2, datë.24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit 2025”, ,ne VKB nr.115 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”, në relacionin, nr.1745 prot, datë.29.04.2025, “Mbi vlesimin e situates financiare dhe sociale te z.Kastriot Gjini Perlika”, e sektorit të shërbimit social, Bashkia Mirditë, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkisë;

V E N D O S I:

I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 60 000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;

1.Të japë ndihmë financiare familjes së z.Kastriot Gjini Perlika, banues Rreshen, NJA Rreshen, për kushtet të vështira jetese.

a-Paksim:fondi rezervë (A1133 00 2133001 01 V491AAA..604) për shumën 60 000 lekë

b-Shtohet (AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën 60 000 lekë

.2.Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, 5 000 lekë në muaji për një periudhë një vjeçare (maji 2025-prill 2026), zyra Postare Rreshen .

II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori e finances dhe buxhetit.

III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Gaspër TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksander PICAKU

Paraqiten projektin

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Dr.Juridike, prok, protokoll: M.Doda

KRYETARI
Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.a



BASHKIA MIRDITË

AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE

Nr. 1745 Prot.

Rrëshen, më 29.04.2025

Lënda: Relacion

Drejtuar: Drejtorisë së Financës së Bashkisë Mirditë

Lidhur me rastin e Kastriot Gjini Përlika, po ju japim relacionin si më poshtë:

Z.Kastriot Gjini Përlika, i lindur në Lufaj të njesisë administrative Selitë më 19.06.1974, me NID H40619034Q jeton së bashku me bashkëshorten dhe djalin 17 vjeçar në pallatet e ndërtuara nga Projekti i tërmetit, në një banesë 2+1.

Kastrioti, prej gjashtë viteve përfiton statusin e Paraplegjikut, ku aktualisht përfiton shumën prej 16 324 lekë. Deri përpara dy vitesh ka përfituar edhe paketën higjieno – sanitare, ku masa e përfitimit arrinte në 36 324 lekë. Bashkëshortja është e papunë, pasi përkujdeset për bashkëshortin, ndërsa djali është nxënës në vitin e dytë tek Shkolla Profesionale. Problemet shëndetësore të tij kanë filluar që në fëmijëri, ku ai ka pësuar një djegie të këmbëve dhe ka përfituar statusin e paafëtisë. Së fundmi, ai ka bërë një ndërhyrje në Lezhë tek reparti i Ortopedisë në Lezhë, ku nuk kanë dhënë shpresë për vendosjen e protezave, pasi kocka e këmbës është shumë e dobët dhe nuk e mban peshën e trupit.

Shuma mujore që kjo familje përfiton është e pamjaftueshme duke konsideruar nevojat e shumta që kjo familje ka, prandaj ne si Shërbim Social e konsiderojmë të nevojshme dhënien e një mbështetjeje financiare për këtë familje, sidomos për gjenden shëndetësore të Kastriotit.

Konceptoi: Adela Gjikota

Miratoi: Drejtori Aurel Çupi

Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni

ADRESA: SHESH "ABAT DOÇI", RR. SHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al